



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 6-të të KPF-së Lipjanit mbajtur, më 30.07.2026, në sallën numër 2 , kati i 3-të , me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Armend Grajçevci, anëtar
3. Anila Reçica - Llugiqi, anëtare
4. Elmaze Behluli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Gashi, anëtare
7. Alban Salihu anëtar

Të tjerë prezent :

1. Latif Ramadani, DBF
2. Imri Semetishti DPUMM

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Naser Bytyqi**.

Kryesuesi i KPF-së, Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë të cilin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 5-të e KPF-së
2. Raporti monitorues për zbatimin e Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit për periudhën 1 Korrik 2025 – 30 Qershor 2026.
3. Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Lipjanit.
4. Propozim Vendim për zëvendësimin- ndryshimin e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi- KKS-së.
5. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2026.

6. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit për vitin 2025 dhe Plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit të pranuar me raportin final nga Auditori i Zyrës kombëtare të Kosovës për vitin 2025, të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit.
7. Raporti vjetor për NJAB për vitin 2025.
Po ashtu tha se me propozim të ekzekutivit keni edhe një pike shtese për rend të ditës.
8. Propozim Vendimi për subvencionimin e qirasë joprofitabile për përfituesit e banimit social

Meqë vërejtje as plotësime nuk pati Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, aprovoi rendin e ditës me pikët e propozuara.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 5-të e KPF-së.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreth ekstraktit.

Meqë diskutime as vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, aprovoi ekstraktin nga mbledhja e 4-të e KPF-së.

II

Raporti monitorues për zbatimin e Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit për periudhën 1 Korrik 2025 – 30 Qershor 2026.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishtit, drejtor i DPUMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha se pse vitin e kaluar s'ka qenë ky raport në diskutim.

Imri Semetishti, tha se s'ka qenë për shkak se ka qenë vit zgjedhor dhe nuk kemi mujt me qit për diskutim për Kuvend.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

III

Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit, drejtor i DKA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

IV

Propozim Vendim për zëvendësimin- ndryshimin e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi- KKSBB-së.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

Pastaj Kryesuesi, tha se pikat,5,6 dhe 7 raportet a pajtoheni që të shkojnë direkt në Kuvend.

Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

V

Propozim Vendimi për subvencionimin e qirasë joprofitabile për përfituesit e banimit social

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, aprovoi propozimin

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11:30

Ekstraktin e hartoi

Kryesuesi i KPF-së

Behar Aliu

Daut Azemi